

---

**ikubINFO** Shpk është kompania më e madhe për enterprise software engineering në Shqipëri.

Me një staf prej mbi 90 zhvilluesish, gjithnjë në rritje, me njohuri dhe eksperiencë të gjerë në fusha të ndryshme, **ikubINFO** po zgjeron aktivitetin e saj me projekte ambicioze si brenda dhe jashtë vendit.

Me qëllim përgatitjen profesionale të zhvilluesve, prej 6 vitesh Kompania ka ngritur Akademinë ikubINFO dhe aktualisht planifikon zgjerimin e aktivitetit të saj.

Akademia ikubINFO ka këto aktivitete kryesore:

1. trajnime hands-on (pa pagese) i të rinjve që synojnë të bëhen zhvillues software;
2. trajnime me pagesë për kurse të specializuara te zhvillimit të software;
3. trajnime të shpejta (fast-track) për qëllime specifike të tregut apo të vetë kompanisë;
4. nxitje dhe mbështetje e talenteve të reja me ide inovative.

Aktualisht, **ikubINFO** është në kërkim të kandidatëve të apasionuar dhe me eksperiencë në fushën akademike dhe zhvillimit software, të cilët dëshirojnë t'i bashkohen grupit të tij të profesionistëve në pozicionin:

Drejtori i Akademisë është përgjegjës për menaxhimin e proceseve të Akademisë ikubINFO, për forcimin e imazhit të saj, dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.

## **Drejtor i Akademisë ikubINFO**

### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Përfaqëson akademinë në komunitetin akademik dhe të biznesit, në evente dhe aktivitete të ndryshme publike, duke vepruar

si personi kyç i marrdhënies me publikun për akademinë.

- Propozon dhe ndjek nga afër fushata të ndryshme me qëllim zgjerimin dhe rritjen e Akademisë dhe aktivitetit të saj.

- Krijon dhe ruan marrdhënie me rrjetin e grupeve të interesit, me qëllim informimin për kërkesat e tregut për trajnime që lidhen

me fushën e zhvillimit software dhe propozon trajnime, paketa, apo seksione të ndryshme me pagesë.

- Shërben si mediator në menaxhimin e marrdhënieve dhe si një linjë e drejtperdrejtë komunikimi mes të trajnuarve dhe

kompanisë ikubINFO.

- Harton dhe ndjek në zbatim kalendarin dhe programin akademik të grupeve të akademisë dhe atë të trajnimeve me pagesë.

- 
- Organizon dhe ndjek nga afër të gjitha fazat e procesit të rekrutimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për pjesmarrje në Akademi.
  - Është përgjegjës për koordinimin dhe menaxhimin e lektorëve të brendshëm dhe të jashtëm të akademisë dhe stafit mbështetës.
  - Përcakton objektivat e performancës së stafit të akademisë dhe atij mbështetës, jep vlerësim për performancën e tyre dhe i mbështet dhe udhëheq që të performojnë sa më mirë.
  - Propozon dhe mbikqyr procedurat e përditshme për stafin dhe të trajnuarit.
  - Krijon dhe ndjek planet e biznesit për trajnimet me pagesë. Propozon tek Bordi Drejtues dhe më pas ndjek planin e buxhetimit vjetor dhe ecurinë e të ardhurave dhe shpenzimeve.
  - Ndjek, evidenton dhe propozon për zhvillim, brenda akademisë, projekte dhe ide të ndryshme start-up në mbështetje të kthimit të saj në një qënder të mirfilltë inovacioni, dhe zhvillimi të talenteve dhe ideve të ndryshme në programim.
  - Përgatit raporte mujore, tremujore dhe vjetore si dhe bën prezantime të ecurisë së akademisë përpara Bordit Drejtues.
  - Raporton drejtperdrejt tek Administratori i Përgjithshëm.

**Kritere përzgjedhëse:**

- Diplomë universitare në një nga degët e Informatikës.
- Minimalisht 3 vite eksperiencë në mësimdhënie.
- Njohje të mira të gjuhëve të programimit Java dhe .NET.
- Të ketë çertifikata që dëshmojnë kualifikime të ndryshme në fushën e programimit.
- Eksperiencë në menaxhim është favorizuese.

Kandidatet e kualifikuar duhet të nisin një leter interesi, CV e përditësuar dhe kopje të dokumentave mbështetëse duke përfshirë dhe letrat e referencës në adresën e e- [hr@ikubinfo.al](mailto:hr@ikubinfo.al) me subjektin Drejtor Akademi.

*“Informacioni personal që do të vendosni në aplikimin tuaj do të mbrohet dhe përdoret vetëm për qëllime rekrutimi bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale Ligji Nr.9887, datë 10.03.2008*